

Ma. Teuta SHALA-PELI

AKTIVITETET E INSTITUTIT TË HISTORISË PRISHTINË GJATË VITIT 2012 (maj 2012-shtator 2012)

Gjatë vitit 2012 Instituti i Historisë-Prishtinë organizoi një sërë aktivitetesh shkencore, në kuadër të shënimit të 100 vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, të cilat në fokus kishin shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë si dhe ngjarjet që i paraprinë asaj.

Aktiviteti i parë për shënimin e këtij jubileu u mbajt në prill me rastin e 100 vjetorit të themelimit të shoqatës “Vatra”, me ç’rast u organizua akademia Kujtesë Historike. Pas kësaj, në maj u mbajt përsëri një akademi Kujtesë Historike kushtuar, “100 vjetori të Kuvendit të Junikut”, si dhe më 13 dhe 14 shtator u mbajt Konferenca Shkencore “Pavarësia e Shqipërisë dhe Kosova 100 vjet pas”.

Në vazhdim do të paraqes aktivitetet shkencore të organizuara nga Instituti i Historisë-Prishtinë gjatë viti 2012, duke u bazuar gjithnjë në kronologjinë e mbajtjes së aktivitetit shkencor.

I. AKADEMITË

1. AKADEMIJA – KUJTESË HISTORIKE KUSHTUAR 100–VJETORIT TË THEMELIMIT TË FEDERATËS PANSHQIPTARE VATRA

Instituti i Historisë-Prishtinë në bashkëpunim me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, në kuadër të shënimit të 100–vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë aktivitetet e tyre shkencore për kremtimin e këtij jubileu i hapën me akademinë-Kujtesë Historike kushtuar 100 vjetorit të themelimit të Federatës Panshqiptare Vatra, e cila u mbajt më 25 prill 2012 në mjediset e ASHAK-ut. Në këtë akademi u mbajtën dy fjalë rasti dhe një kumtesë.

Fjalën e hapjes së akademisë e mbajti kryetari i ASHAK-ut – akademik Hivzi Islami, i cili vuri në pah rolin e Federatës Panshqiptare Vatra dhe të shqiptaro-amerikanëve për sensibilizimin e çështjes shqiptare që nga viti 1912 e deri tek Pavarësia e Kosovës në vitin 2008.

Duke elaboruar këtë segment mjaft të rëndësishëm të Federatës Vatra si dhe të shqiptarëve të Amerikës, ai vuri në dukje se ata dhanë një kontribut të madh për themelimin e shtetit shqiptar në kufijtë e sotëm. Si Pavarësia e Shqipërisë më 1912, ashtu edhe Pavarësia e Kosovës në vitin 2008 nuk

do të vinin pa një mbështetje të fuqishme të SHBA-ve dhe dy kryetarëve të tyre, Vudrou Vilsonit në vitet 1919-1920 dhe Bill Klintonit më 1999, por senzibilizimin, me krejt mundësitë që kishin, e bënë pa mëdyshje patriotët shqiptaro-amerikanë dhe gjithë komuniteti shqiptar i atjeshëm.

Në fjalën përshëndetëse ambasadori i Shqipërisë në Kosovë Dr. Islam Lauka, pasi i bëri një vlerësim rolit dhe rëndësisë së Federatës Vatra, konkludoi se kjo Federatë mbarë shqiptare ka shërbyer si një ambasadë në Amerikë për interesat e kombit shqiptar. Po ashtu, ambasadori Lauka vuri në dukje se lindja e Federatës Vatra i parapriu lindjes së shtetit shqiptar.

Prof. dr. Jusuf Bajraktari, drejtor i Institutit të Historisë-Prishtinë, prezantoi kumtesën "Vatra" – një shekull në shërbim të çështjes shqiptare". Duke prezantuar kontributin 100 vjeçar të federatës Vatra, Prof. dr. Jusuf Bajraktari vuri në dukje se "Vatra" me historinë e saj njëshekullore i dha dritë e shkëlqim përhapjes së idesë për bashkimin dhe organizimin e luftës çlirimtare të popullit shqiptar. Sot, me rastin e shënimi të 100 – vjetorit të themelimit të "Vatres", këtij jubileu të rëndësishëm të historisë politike e të kulturës shqiptare, mund të themi me të drejtë se vlerat e saj janë vlerat e historisë 100 vjeçare të kombit shqiptar, theksoi ai.

Në fund të pranishmit patën rastin të dëgjojnë fjalimin e incizuar të Fan Nolit mbajtur më 1962 në Federatën shqiptaro-amerikane "Vatra".

2. AKADEMIJA-KUJTESË HISTORIKE KUSHTUAR 100 VJETORIT TË KUVENDIT TË JUNIKUT

Instituti i Historisë-Prishtinë, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës si dhe Kuvendi Komunal i Junikut, më 21 maj 2012 organizuan në Junik akademinë kushtuar 100 vjetorit të themelimit të Kuvendit të Junikut.

Fjalën përshëndetëse në akademinë Kujtesë Historike për nder të 100 vjetorit të Kuvendit të Junikut e mbajti z. Agron Kuqi kryetar i Kuvendit Komunal të Junikut. Në fjalën e tij përshëndetëse kryetari Kuqi vuri në dukje se njëqindvjetori i Kuvendit të Junikut, përbën njërën ndër ngjarjet më të rëndësishme të historisë së kombit shqiptar. Më tej, z. Agron Kuqi theksoi se pikërisht para 100 vjetëve në Junik, shumë patriotë shqiptarë, drejtues të kryengritjes dhe shumë luftëtarë të lirisë, arritën për të marrë vendime për të ardhmen e Shqipërisë.

Ndërsa, kryetari i Kuvendit të Kosovës Dr. Jakup Krasniqi në fjalën e tij përshëndetëse, pasi vlerësoi lart këtë ngjarje të rëndësishme të historisë sonë kombëtare, beri një vështrim kronologjik të Besëlidhjeve shqiptare duke filluar nga 2 marsi i vitit 1444, kur feudalët shqiptarë të prirë nga

Skënderbeu formuan një besëlidhje, që në historinë tonë e njohim si Kuvendi (Besëlidhja) i Lezhës, për të përfunduar me Kuvendin apo besëlidhjen e Junikut. Krahas kësaj kryeparlamentari Krasniqi pranverën e vitit 1912 e konsideroi se ishte një paralajmërim i ri i një moti sa të lavdishëm e heroik, aq edhe të dhimbshëm e tragjik për më shumë se gjysmën e kombit shqiptar.

Në akademinë kushtuar 100 vjetorit të Kuvendit të Junikut me një fjalë rasti u paraqit edhe Ministri i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë Dr. Ram Buja. Ministri Buja tha se Kuvendi i Junikut me programin e tij kombëtar, organizuar në kohë dhe rrethana të vështira, kur populli shqiptar po angazhohej për pavarësinë e vet ndikoi në zgjerimin e kryengritjes, duke u bërë kështu gurthemel i qëndrësës dhe rezistencës.

Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, z. Islam Lauka, në fjalën përshëndetëse ndër të tjera vlerësoi se “Shqipëria nuk është më ajo, që dikur rrinte pas dyerve të konferencave ndërkombëtare, por ajo është në tryezat e të gjitha takimeve të larta botërore, është anëtare e NATO-s dhe së shpejti do të jetë anëtare e BE-s”.

Në akademinë Kujtesë Historike kushtuar 100 vjetorit të Kuvendit të Junikut, me fjalë përshëndetëse u paraqit edhe akademik Pajazit Nushi, i cili vlerësoi lartë rolin e Kuvendit të Junikut në ngjarjet e vitit 1912.

Ndërkaq, me një ekspozitë në akademinë në fjalë u paraqit prof. dr. Jusuf Bajraktari drejtor i Institutit të Historisë-Prishtinë. Në ekspozitën “Kuvendi i Junikut promotor i kryengritjes së përgjithshme të vitit 1912”, fillimisht vuri në dukje se me këtë akademi në formën e kujtesës historike dhe mitingun solemn që po mbahen sot në Junik, shënojmë jo vetëm 100 vjetorin e një ngjarjeje madhore të historisë sonë, por rikujtojmë me respekt të gjitha përpjekjet dhe betejat e vogla dhe të mëdha të këtij populli për lirinë dhe pavarësinë e vonuar prej një shekulli.

II. KONCERENCAT SHKENCORE

KONCERENCA SHKENCORE “PAVARËSIA E SHQIPËRISË DHE KOSOVA-100 VJET PAS”

Më 13-14 shtator 2012, në Prishtinë u mbajt Konferenca Shkencore, “Pavarësia e Shqipërisë dhe Kosova-100 vjet pas”, e organizuar nga Instituti i Historisë-Prishtinë dhe Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

Në këtë Konferencë dyditore u lexuan 32 kumtesa shkencore, duke sjellë fakte të reja, në prag të 100-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë.

Në fjalën e hapjes akademik Hivzi Islami, kryetar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, theksoi: se viti i madh 1912 ishte edhe vit që prodhoi pasoja të tjera për shqiptarët në pikëpamje politike-shtetërore trungru gjeoetnik u nda, me ç'rast Kosova dhe viset përreth mbetën jashtë Shqipërisë politike.

Në fjalën përshëndetëse kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë Akademik Gudar Beqiraj, theksoi se "Është nder dhe kënaqësi e veçantë për mua, që t'i sjell Konferencës suaj përshëndetjet e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Me shpalljen e Pavarësisë u realizua programi madhor i Rilindjes Kombëtare, ndonëse pjesërisht për shkak të mospërfshirjes në kufijtë e shtetit shqiptar të të gjitha trojeve, u shpreh akademik Beqiraj.

Punimet e Konferencës Shkencore filluan me kumtesën e prof. dr. Jusuf Bajraktarit drejtor i Institutit të Historisë Prishtinë, "Kryengritjet në Kosovë 1908-1912 dhe Pavarësia e Shqipërisë". Vitet 1908-1912 në historinë e popullit shqiptar janë vitet e përpjekjeve, organizimeve dhe kryengritjeve të shumta për liri dhe autonomi, të cilat çuan deri të akti sublim i shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, theksoi prof. dr. Jusuf Bajraktarit në kumtesën e tij.

Akademik Pajazit Nushi, mbajti kumtesën "Mendimi akademik dhe urrejtja serbe ndaj shqiptarëve", duke potencuar faktin se derisa studiuesit, sidomos ata të Kosovës argumentojnë kontinuitetin e zhvillimit në viset e tyre që nga koha ilire, serbët mbështesin pikëpamjen e tyre për ndryshimet e zhvillimit në viset e tyre që nga koha ilire, pra për ndryshimet etnogjeneze, humbjen e lidhshmërisë duke i trajtuar shqiptarët të ardhur në këto vise që nga shekulli XVI. Këto qëndrime u manifestuan me urrejtje grindje dhe konflikte deri në kohët me të reja.

Akademik Beqir Meta, drejtor i Institutit Historisë-Tiranë, në kumtesën "Afirmimi i institucioneve kombëtare në vitet 20-30 të shek. XX", theksoi: "Si vendi më i vogël, më i varfër dhe më i dobët i Ballkanit, fati i Shqipërisë u ndikua fuqimisht nga forcat jashtë saj. Lufta për të drejtën e ekzistencës si komb-shtet, ndërkohë që fqinjët e Shqipërisë përpiqeshin të nxirrin në pah faktorët përçarës, pati ndërlikime të rëndësishme.

Prof. dr. Eminë Bakalli, paraqiti kumtesën "Revolucioni Nacional Shqiptar i vitit 1912". Në kumtesën e saj ngriti çështjen se lëvizja e armatosur e shqiptarëve për autonomi e vitit 1912 a ishte një kryengritje apo në fakt një revolucion. Ajo shtoi se autorët e jashtëm pa farë hezitimi këtë ngjarje e mbulojnë me termin revolucion, ndërsa historianët dhe letrarët të tjerë shqiptarë insistojnë në perceptimin e saj si kryengritja e përgjithshme shqiptare e vitit 1912.

Prof. dr. Valentina Duka, mbajti kumtesën “Ismail Qemali dhe institucionet ndërkombëtare që vepronin në Shqipëri gjatë vitit 1913”. Duke folur për institucionet ndërkombëtare që vepronin në Shqipëri gjatë vitit 1913, u përqendrua tek Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (KNK) i cili në gusht të vitit 1913 kishte arritur në Vlorë. Sipas studiueses Duka çështja kryesore e cila u kthye në një mollë sherri midis KNK-së dhe Ismail Qemalit, duke filluar nga tetori i 1913 dhe që vazhdoi deri sa ai dha dorëheqjen, ishte çështja e legjitimitetit kombëtar të qeverisë së Vlorës.

Prof. dr. Isa Bicaj, në kumtesën e tij “Vendosja e pushtetit malazias në viset e pushtuara 1912-1913”, u përqendrua tek vendosja e pushtetit malazez në Kosovë gjatë viteve 1912-1913, duke potencuar se vendosja e këtij pushteti u karakterizua me masa të ashpra si çarmatimi i popullsisë, konvertimi nga feja myslimane dhe katolike në atë ortodokse. Të gjitha këto masa të ndërmarra nga Qeveria e Malit të Zi kishin për qëllim shpërnguljen e shqiptarëve për në Shqipëri dhe Turqi.

Prof. dr. Ferit Duka, në kumtesën e tij “Faktorët e përçarjes dhe regresit në Shqipërinë e pavarur-Esat Toptani”, vuri në dukje se themelimi i shtetit të pavarur shqiptar nga Ismail Qemali dhe bashkëpunëtorët e tij, e brengosi së tepërmi pashain toptanas i cili e ndjeu veten të mënjeluar nga protagonizmi në një ngjarje të tillë madhore, rrjedhimisht edhe të privuar nga mundësi për të qenë ai i pari i Shqipërisë dhe askush tjetër. Në këtë kontekst thekson prof. dr. Ferid Duka, Esat Toptani vë në zbatim tërë arsenalin e mjeteve që kishte për të sabotuar e goditur shtetin e ri shqiptar.

Prof. dr. Frashër Demaj, paraqiti kumtesën “Qëndrimi i diplomacisë së Fuqive të Mëdha lidhur me kërkesën e Serbisë për dalje në Detin Adriatik”. Duke folur për kërkesën e Serbisë për të dal në Adriatik, si dhe këmbënguljen e saj për t’ia arritur këtij qëllimi, vuri në dukje se përballë një gjendjeje të tillë qeveria britanike ndërmori hapa serioz, duke treguar se kufijtë e Shqipërisë janë rezervuar për t’u përcaktuar nga Fuqitë e Mëdha.

Prof. dr. Ilira Çausi, mbajti kumtesën “100 vjet heraldikë shqiptare”. Në kumtesën e saj ajo bëri një vështrim përmbledhës të zhvillimit të heraldikës shqiptare duke filluar që nga viti 1912 pra shpallja e Pavarësisë e deri më sot.

Akademik Marenglen Verli, prezantoi kumtesën “Çështja e Kosovës dhe Shqipëria 1918-1939”. Ai u fokusua kryesisht në çështjet kryesore që karakterizojnë Kosovën dhe Shqipërinë gjatë viteve 1918-1939.

Prof. dr. Fehmi Rexhepi, mbajti kumtesën “Qëndrimet e forcave politike në Kosovë gjatë Luftës së Dytë Botërore”. Ai vuri në dukje se forcat politike në Kosovë dhe rreth Kosovës në përgjithësi gjatë Luftës së Dytë Botërore u rreshtuan në dy blloqet kundërshtarë. Në Bllokun e Fuqive të Boshtit dhe në Bllokun e Koalicionit Antifashist.

Prof. dr. Ana Lalaj, u prezantua me kumtesën “Britanikët për Kosovën: brenda apo jashtë shtetit shqiptar 1941-1945”, ajo u përqendrua tek qëndrimi i Britanisë karshi çështjes së Kosovës. gjatë viteve 1941-1945.

Prof. dr. Habil Árpád Hornják, në kumtesën “Politika e Hungarisë ndaj Ballkanit midis dy Luftërave Botërore”, u përqendrua tek politika e Hungarisë ndaj Ballkanit, duke ardhur në përfundim se politika e Hungarisë Ballkani u ndikua nga tre faktorë: interesi ekonomik, mbajtja e epërsisë hungareze në pellgun Karpatian si dhe ruajtja e mbretërisë hungareze.

Akademik Esat Stavileci, në kumtesën e tij “Evolucioni kushtetues i Kosovës 1946-1990”, foli për procesin e evoluimit të kushtetutës së Kosovës për një periudhë gati gjysmëshekullore.

Dr. Fehari Ramadani, në kumtesën “Shkollat austro-hungareze në Vilajetin e Kosovës në vitet 1911-1912”, vuri në dukje se në territoret shqiptare funksiononin 30 shkolla të financuara nga qeveria e Vjenës. Vjena u kujdes edhe për furnizimin e atyre shkollave me tekste mësimore, duke dhënë një kontribut të rëndësishëm për arsimimin e të rinjve shqiptar të asaj kohe, e sidomos për ata të besimit katolik.

Mr. Sylë Ukshini, prezantoi kumtesën “Diplomacia austro-hungareze dhe çështja shqiptare në kohën e Luftërave Ballkanike 1912-1913”. Duke folur për luftërat ballkanike të zhvilluara gjatë viteve 1912-1913, u përqendrua sidomos tek qëndrimi i diplomacisë austro-hungareze lidhur me çështjen shqiptare në kohën e luftërave ballkanike.

Dr. Teki Kurti, në kumtesën “Qëndresa e shqiptarëve në Kosovë 1913-1914 sipas shtypit në Shqipëri”, pasi analizoi pasqyrimin e kësaj ngjarjeje në shtypin e kohës, ai u fokusua tek gazetat “Përlindja e Shqipërisë”, “Shqypnia e Re”, duke konkluduar se shtypi i Shqipërisë në fillim të pavarësisë së saj luajti një rol pozitiv në çështjen kombëtare të kohës.

Dr. Sefer Tahiri, prezantoi kumtesën “Kontributi kombëtar i gazetës Shkupi”, duke dimensionuar veprimtarinë e gazetës Shkupi, potencoi se gazeta Shkupi merrej me problemet e rrafshit kombëtar në shumë dimensione : politike, arsimore dhe kulturore, është një dëshmi e kohës, një argument i qenies kombëtare dhe një fakt që konkludon se media e shkruar në gjuhën shqipe ka pasur gjithmonë guximin, përkushtimin dhe angazhimin kombëtar.

Prof. dr. Agim Zogaj, në kumtesën “Çështja e Kosovës në marrëdhëniet shqiptaro-jugosllave 1941-1948”, vuri në dukje se rezistenca shqiptare ndaj ripushtimit u frymëzua përmes organizimeve ushtarako-politike të NDSH-së dhe pastaj edhe përmes Lëvizjes Atdhetare për Çlirim nga sundimi serb e cila ndërmori organizime për t'i rezistuar dhunës dhe pushtimit.

Prof. dr. Arsim Bajrami, mbajti kumtesën “Aspekte legale dhe kushtetuese të Pavarësisë së Kosovës”. Rrugëtimi i Kosovës drejt rrugës

për të ndërtuar shtet dhe për të vendosur për fatin e saj deri para vitit 1913 ende nuk kishte filluar. Ishte Konferenca e Ambasadorëve në Londër ajo që i ndau rrugët e shqiptarëve pa dëshirën e tyre, theksoi ai.

Dr. Edita Tahiri, u paraqit me temën “Kosova në Konferencën e Rambujesë”. Duke e trajtuar Konferencën e Rambujës si njëri ndër ngjarjet më të rëndësishme në historinë e re të Kosovës dhe shqiptarëve, fillimisht ajo hodhi një vështrim në trajtimin e çështjes shqiptare në konferencat e mëhershme ndërkombëtare, pastaj u ndal tek roli i Konferencës së Rambujës në zgjedhjen e çështjes së Kosovës dhe në fund shqyrtoi ndikimet e Konferencës së Rambujës në gjeopolitikën shqiptare.

Gjeneral Agim Çeku, në kumtesën, “Lufta e UÇK-së dhe çlirimi i Kosovës”, u ndal tek dalja në skenë e UÇK-së e cila përbën një ngjarje madhore në historinë e Kosovës dhe popullit shqiptar. Roli i saj në luftën çlirimtare të Kosovës nga okupimi serb është zakonisht i madh dhe i pazëvendësueshëm theksoi më tutje Gjeneral Agim Çeku.

Dr. Rexhep Osmani, u prezantua me kumtesën “Pavarësimi i arsimit shqip në Kosovë 1990-1999”, duke analizuar pavarësimin e arsimit shqip në Kosovë ai u ndal edhe tek sfidat shkollës shqipe përkatësisht arsimit shqip në Kosovë gjatë viteve 1990-1999.

Prof. dr. Sulltane Ukaj, në kumtesën “Inteligjenca kosovare përballë dhunës dhe represionit serb (1981-1999)”, vuri në pah se inteligjenca shqiptare ishte ideatore dhe prijëse e proceseve historike në rrethanat më kritike për kombin në përpjekje për liri dhe pavarësi.

Prof. dr. Izber Hoti u paraqit me kumtesën “Pavarësia në diakroninë e historisë shqiptare”. Në kumtesën e tij prof. dr. Izber Hoti vuri në dukje se sintagma liri dhe pavarësi në kontekstin semantik dhe semasiologjik gjatë shekujve ka marrë konotacione të ndryshme, mirëpo esenca mbeti e njëjtë.

Mr. Skender Hasani paraqiti kumtesën “Propozimi i Bertholdit i vitit 1912 për çështjen shqiptare sipas shtypit bullgar”. Sipas tij shtypi bullgar konstatonte se Austro-Hungaria ia impononte programin e decentralizimit Perandorisë Osmane, ndërsa më qellim që të realizojë aspiratat e veta, ajo synonte krijimin e një Shqipërie me katër vilajete shqiptare.

Prof. dr. Muhamet Mustafa & Ma. Lumir Abdixhiku, mbajtën kumtesën “Sprovat e rritjes së qëndrueshmërisë ekonomike”. Në kumtesën e tyre u përqendruan tek problemet me karakter ekonomik, duke u ndalur me theks të veçantë tek sprovat e qëndrueshmërisë ekonomike.

Mr. Fitim Rifati, mbajti kumtesën “Kuvendet shqiptare (1908-1912) dhe platformat e tyre”. Ai vuri në pah rolin kuvendeve shqiptare duke potencuar se kuvendet shqiptare të viteve 1908-1912 ndikuan në ngritjen e vetëdijes dhe në përvetësimin e ideve përparimtare kombëtare.

Prof. dr. Violeta Nushi, në kumtesën e saj “Qëndrueshmëria urbano-arkitektonike e Kompleksit të Lidhjes së Prizrenit”, konkludoi se qëndrueshmëria urbano – arkitektonike e bërthamave historike të shumë qyteteve e vendeve me qytetërime të lashta gjatë periudhave të tranzicioneve të ndryshme shoqërore, janë viktime të infrastrukturës së përkeqësuar në vijimësi si dhe të spekulimeve të pasurive të patundshme.

Mr. Parim Kosova, u paraqit me kumtesën “Shpërnguljet e shqiptarëve pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë 1912-1918”. Duke folur për këtë problem ai theksoi se gjithmonë gjatë historisë njerëzit për të siguruar kushte më të mira për ekzistencë janë zhvendosur nga një vendbanim në një tjetër, mirëpo gjatë periudhave të ndryshme të historisë si të shumë popuj të tjerë edhe të iliro-shqiptarët kemi pas zhvendosje të dhunshme.

Dr. Sabit Syla, prezantoi kumtesën “Shpërngulja e shqiptarëve nga Kosova (1950-1980) sipas dokumenteve diplomatike shqiptare”. Duke e elaburuar këtë problem ai vuri në pah se në vitet 50-80-të, të shekullit XX, udhëheqja politike shtetërore e Tiranës, nga burime të ndryshme informative-diplomatike, posedonte pothuajse të gjitha statistikat zyrtare të botuara në buletinet statistikore jugosllave e më gjerë për numrin e popullsisë shqiptare, rrjetin e tyre arsimor, kulturor e politik.

Dr. Petrit Gashi në kumtesën e tij “Shqipëria treg apo rrugë transiti për prodhimet e Kosovës”, u përqendrua tek lidhjet ekonomike në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, veçanërisht përparësitë që ofron Shqipëria për Kosovën si treg dhe si rrugë lidhëse me tregjet globale.

Fjalën e mbylljes së Konferencës Shkencore “Pavarësia e Shqipërisë dhe Kosova-100 vjet pas” e mbajti prof. dr. Jusuf Bajraktari. Pasi bëri një rezymim të punës dy ditore të Konferencës në fjalë theksoi se “pas dy ditë pune intensive Konferenca Shkencore po i mbyll punimet e saja, me bindjen tonë të përgjithshme për arritjen e rezultateve të reja shkencore, të cilat sigurisht do të jenë edhe një nxitje e mëtejshme për studiuesit e historisë, por edhe ata të problemeve juridike, ekonomike, politike dhe të specialisteve tjerë të fushës së albanologjisë dhe ballkanologjisë, për të thelluar njohuritë e tyre dhe ato për t’i prezantuar në tribuna si kjo për opinionin shkencor.